

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.25.01.2023*

**25.01.2023
Ora 11:15**

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për miratimin e elementeve dhe përmbajtjes së zarfeve të sigurisë që do të përdoren në zgjedhje”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Stafi KQZ: **Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja,
Znj. V. Ballgjini, Z. E. Meta**
- **Parti Politike:**
- **Të tjerë: KRIIK**

Z. I. Celibashi: Mirëdita të gjithëve, në seancën e sotme publike kemi këto çështje në rend dite:


Projektvendim “Për miratimin e elementeve dhe përmbajtjes të zarfeve të sigurisë që do të përdoren në zgjedhje”, është akt i përgjithshëm.

Pika e dytë, “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja dhe mediave”.

Pika e tretë, ka të bëjë me një raport të vlerësimit të ecurisë së raportimeve të veprimtarive publike të institucioneve.

Dhe e mbartur, projektvendimi “Për përcaktimin e rregullave për raportimin financiar vjetor të partive politike, miratimin e formatit të standardizuar për raportimin financiar të partive politike gjatë vitit kalendarik, kontrollin, verifikimin

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.25.01.2023*

e financimeve dhe shpenzimeve të tyre, si dhe mënyrën e pagesës së audituesve ligjorë”.

Atëherë, në lidhje me pikën e parë të rendit të ditës në lidhje me elementet dhe përmbajtjen e zarfeve të sigurisë që do të përdoren në zgjedhje

Z. Y. Merkaj: Në mbështetje të nenit 19, pikat 1 e 2 dhe nenit 99 të Kodit Zgjedhor, parashikojnë kompetencën e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për miratimin e modeleve të zarfeve të sigurisë, që do të përdoren në zgjedhje. Neni 99, pika 1, neni 118, pika 5, neni 119, pika 3, dhe neni 120, pika 5, të Kodit Zgjedhor, parashikon si pjesë të procedurave, përdorimin e zarfeve të sigurisë për administrimin e fletëve të votimit gjatë vlerësimit dhe numërimit të tyre nga grupet e numërimit, si dhe mbylljen në zarf të veçantë të procesverbalit të mbylljes së kutisë së votimit para fillimit të procesit të votimit. Gjithashtu Kodi Zgjedhor, në nenin 120, pika 5, parashikon dhe zarfe sigurie për administrimin e fletëve të votimit të hedhura gabim, të ndara sipas llojit të organit për të cilin janë hedhur. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, për të pajisur komisionet përkatëse me zarfat e sigurisë, sipas nenit 99, 118, 119 dhe nenin 120 të Kodit Zgjedhor, duhet të miratojë modelin për çdo zarf sigurie, si dhe të marrë masa për prodhimin dhe dërgimin e tyre për çdo qendër votimi. Në zbatim të përcaktimeve të Kodit Zgjedhor, për të unifikuar praktikën zgjedhore, ka përgatitur modelet e zarfave të sigurisë, përmbajtja dhe specifikimet të cilat janë të bazuara në nenet e sipërcituara dhe në eksperiencën e zgjedhjeve të mëparëshme zgjedhore. Në projektvendim është përcaktuar se sekretari i Përgjithshëm dhe administrata e KQZ-së do të hartojnë specifikimet teknike/design-in, të cilat do të publikohen dhe shpallen për çdo proces zgjedhor. Kjo qasje e re do të lehtësonte procesin e prokurimit dhe prodhimit të tyre në vijimësi. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.25.01.2023*

Z. I. Celibashi: Mirë, faleminderit! Atëherë meqenëse nuk kemi mendime dhe rekomandime as nga parti politike apo organizata në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës, e miratojmë projektaktin sipas draftit të propozuar.

Vendimi nr. 17

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.25.01.2023*


specializuara ose të angazhuara në mirëqeverisjen dhe demokratizimin, përfaqësuesit e shteteve të huaja dhe mediave. Ky projektvendim vjen në përputhje me parashikimet e Kodit Zgjedhor, si dhe në reflektim të plotë të rolit dhe rëndësisë së vëzhguesve zgjedhorë, në çdo fazë të procesit ku ata akreditohen. Përcaktimi i procedurave të akreditimit, të drejtat dhe detyrat e vëzhguesve si dhe rregullat tërësore të vëzhgimit të zgjedhjeve, mundësojnë përmbushjen me profesionalizëm të detyrës nga ana e tyre. Projektvendimi ka në përmbajtjen e tij 8 nene, të ndara si më poshtë vijon:

- Neni 1 përcakton objektin;
- Neni 2 parashikon procedurën e dorëzimit të kërkesës për akreditimin e vëzhguesve;
- Neni 3 përcakton procedurën e verifikimit të dokumentacionit nga KQZ-ja;
- Neni 4 parashikon kohëzgjatjen e vëzhgimit, në përputhje me afatet e përcaktuara në autorizimin e lëshuar nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve;
- Nenet 5 dhe 6 përcaktojnë të drejtat dhe detyrat e vëzhguesve dhe medias së akredituar;
- Neni 7 shfuqizon udhëzimin nr. 2, datë 02.02.2021, si dhe
- Neni 8 parashikon hyrjen në fuqi të tij.

Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Mirë, do ta shtyjme miratimin e këtij akti pasi të kemi vlerësuar dhe rekomandimet që ka sjellë Organizata KRIIK në lidhje me këtë projektvendim dhe me shumë mundësi ditën e premtë do të përpiqemi të kemi një seancë tjetër. Ndërkohë dhe projektvendimi që ka të bëjë me rregullat e raportimit të raportit financiar vjetor të partive politike, do ta shtyjme dhe këtë për ditën e premtë.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.25.01.2023*


të tillë për të marrë gjithë informacionin e duhur. për të gjykuar më pas kur është rasti për të ndaluar veprimtari të caktuara. Për këtë qëllim në fillim të dhjetorit 2022 janë dërguar shkresa nga Komisioneri të gjitha institucioneve për të dërguar personat e kontaktit, pra të dhënat e tyre për t'u regjistruar në ndërfaqe. Ndërfaqja e raportimeve është bërë e aksesueshme nga çdo person kontakti, që në datën 13 Janar 2023. Për periudhën nga data 13 janar 2023 deri më datë 23 janar 2023, rezulton se:

- 524 institucione të regjistruara në ndërfaqen e raportimeve;
- 169 veprimtari të raportuara;
- 38 institucione raportuese;
- 25 institucione (nga 38) kanë respektuar afatin për raportim (jo më vonë se 5 (pesë) ditë përpara afatit të planifikuar për zhvillimin e veprimtarisë publike;
- 2 institucione kanë raportuar për zhvillim veprimtarie publike, në kushtet e emergjencës për shtatë veprimtari publike.

Ndërkohë janë hasur disa problematika nga 13 janari e deri më sot. Disa institucione kanë hasur vështirësi në aksesimin e ndërfaqes, duke ia bërë me dije Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Problematikat lidheshin kryesisht me pamundësinë për t'u loguar për shkak të disa kufizimeve që lidhen me sigurinë kibernetike që vetë institucionet e tyre kanë pasur. Lista e disa prej institucioneve që hasën problematika në aksesimin është si vijon:

- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
- Ministria e Arsimit dhe Sportit;
- Presidenca;
- Bashkia Elbasan;
- Bashkia Fier;
- Bashkia Roskovec;
- Bashkia Himarë;

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.25.01.2023*

- Bashkia Tiranë;
- Këshilli i Qarku Elbasan;
- Prefektura Tiranë;
- Autoriteti Portual Durrës;
- Agjencia Shtetërore e Kadastrës;
- Autoriteti i Aviacionit Civil;
- Agjencia e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit.

Ndërkohë, për shkak të problematikave që ne konstatuam, kemi bërë një monitorim të ndarë në dy periudha. Për periudhën 13 - 19 Janar ku në shkelje afati këto instuticione:

- Agjencia e Menaxhimit te Burimeve Ujore (1 rast);
- Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (1 rast);
- Agjencia Shteterore e Kadastres (1 rast).
- Autoriteti i Mediave Audiovizive (2 raste);
- Bashkia Durrës (9 raste);
- Bashkia Elbasan (2 raste);
- Bashkia Gramsh (2 raste);
- Bashkia Librazhd (2 raste);
- Bashkia Roskovec (2 raste);
- Bashkia Tiranë (12 raste);
- Kryeministria (1 rast);
- Kuvendi (1 rast);
- Ministër i Shtetit për Marrëdhënien me Parlamentin (4 raste);
- Ministria e Arsimit dhe Sportit (7 raste);
- Ministria e Brendshme (1 rast);
- Ministria e Kulturës (1 rast);

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.25.01.2023*


- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (3 raste);
- Prefekti i Qarkut Lezhë (1 rast);

Ndërkohë kemi bërë monitorim nga data 20 – 23 janar, duke marrë në konsideratë që pas datës 19, pjesa dërmuese e institucioneve kanë aksesuar lehtësisht ndërfaqen dhe pavarësisht kësaj kemi përsëri shkelje të afatit nga institucionet si vijon:

- Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (1 rast);
- Autoriteti i Mediave Audiovizive (1 rast);
- Autoriteti Kombëtar për Çertifikimin Elektronik dhe Sigurinë (1 rast);
- Bashkia Berat (2 raste);
- Bashkia Dimal (1 rast);
- Bashkia Durrës (2 raste);
- Bashkia Elbasan (1 rast);
- Bashkia Librazhd (1 rast);
- Bashkia Lushnje (1 rast);
- Bashkia Roskovec (2 raste);
- Bashkia Tiranë (6 raste);
- Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (1 rast);
- Ministër i Shtetit për Rininë dhe Femijët (2 raste);
- Ministria e Drejtësisë (1 rast);
- Ministria e Kulturës (3 raste);
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (6 raste);
- Prefekti i Qarkut Korçë (2 raste);
- Ujësjellës Kanalizime Cërrik (5 raste);

Për rastet e konstatuar ne sugjerojmë që, të drejtohem në kuadër të hetimit administrativ institucioneve, për të na dhënë shpjegimet dhe për të vijuar më pas me procedurat që ligji përcakton, faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.25.01.2023*

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Dakord! Bëni njoftimet për secilin prej institucioneve për të cilët ka indicie që mund të fillojë një procedurë administrative. Vendosim për datën kur ata do të duhet të paraqesin pretendimet e tyre, pas njoftimit me shkrim, pra shkresës që do t'u bëjmë ne si institucion në lidhje me gjetjet tona. Çështje tjetër nuk kemi, faleminderit! Ditë të mbarë!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

